



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale

Nr. 1591/1 prot

Tiranë më 12 / 08 / 2014

REKOMANDIM

Nr. 67 ,Datë 12/08 2014

Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, bazuar në nenin 29 të ligjit 9887 datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, ka kryer mbikëqyrjen dhe monitorimin e faqes të subjektit tuaj në internet www.interalbanian.com. Nga kontrolli i faqes online të kontrolluesit "Interalbanian" Vienna Insurance Group, u konstatua se:

- Kontrolluesi ofron shërbimin apliko-online, ku kërkohen të dhënat personale të mëposhtme:

The screenshot shows the website for InterAlbanian, part of the Vienna Insurance Group. The main heading is "Sigurimi i banesës" (Home Insurance). Below the heading, there is a navigation menu with "Publikime dhe statistika" (Publications and statistics) and "HOME | HYRJE" (Home | Introduction). The central part of the page is titled "APLIKO ONLINE" (Apply Online) and shows the date "Data: 05/08/2014". The form includes fields for "Emri" (Name) and "Mbiemri" (Surname), a dropdown menu for "ZGJIDH NJE PRODUKT" (Select a product) with the option "Zgjidh Produktin për të cilin aplikon" (Select the product you are applying for), a field for "Shuma e sigurimit" (Insurance amount), and fields for "Nr. telefoni" (Phone number) and "E-Mail". A "APLIKO" (Apply) button is located at the bottom right of the form. On the left side, there are additional menu items: "Raporte vjetore" (Annual reports) with a list of years from 2005 to 2009, "Raporte mujore" (Monthly reports), "Produkte" (Products) with a list of insurance types (individual, business, bank, etc.), and "Partners dhe kliente" (Partners and clients).

- Forma e kontaktit e kontrolluesit ku mblidhen të dhëna të ndryshme personale:

Ju po dergoni mail te Interalbanian.com

Emri _____
 Mbiemri _____
 Kompania _____
 Pozicioni _____
 Shteti _____
 Qyteti _____
 E-mail _____
 Tel _____

Mesazhi _____

DERGO EMAIL

- Kontrolluesi ofron raportimin online të një dëmi duke mbledhur të dhëna personale sipas formularit më poshtë:

NJOFTIMI I DËMI PER SIGURIMIN E PRONES

Data: 05/08/2014

I Siguruarit _____	Nr. i policës së sigurimit _____
Objekti i Siguruar _____	Adresa _____
Vendi i Ndodhjes _____	Data e ndodhjes _____
Numer Telefoni _____	Email _____

Dëmtimi	Adresa ku ndodhesh aktualisht	Kosto e riparimit/ zëvendësimit (sipas mendimit tuaj ose ekspertit)
Ndertesa _____	_____	_____
Makinori&Pajisje _____	_____	_____
Pajisje Zyre _____	_____	_____
Hallra _____	_____	_____
Inventar _____	_____	_____
Totali i kerkuar per dëmshperblim _____		_____

Keni bera ndryshime ne objektin e siguruar? Nëse po, përshkruani _____

A ka funksionuar sistemi i alarmit? _____

Masat e marra për minimizimin e dëmit _____

Fill pasqja bonafide është nevojshet për ndieshen? _____ Data e Njoftimit _____

Emri _____ *

Fjalëkalimi _____ *

Hyri tani

Emri _____ *

Fjalëkalimi _____ *

Hyri tani

Raporto një dëm

Dëm në pronë

Dëm motorik

Dëm shpërndësor

Raport

Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale konstaton se kontrolluesi në rubrikat “Apliko online”, “Kontakt për pyetje” dhe “Njoftimi i dëmit”, aplikantët, kontaktuesit dhe të dëmtuarit plotësojnë formularët përkatës të vënë në dispozicion nga kontrolluesi në faqen e tij online www.interalbanian.com. Përpara se (aplikantët/kontaktuesit dhe të dëmtuarit) të plotësojnë të dhënat e tyre personale në formularë si: emër, mbiemër, adresa e-mailit, nr. telefoni etj. nuk ka një informim paraprak në mënyrë të qartë, të plotë dhe të shprehur në lidhje me përpunimin e të dhënave personale të tyre për qëllimin/et e përpunimit, për kategoritë e të dhënave që mbliidhen dhe përpunohen, për personin apo personat që do ti përpunojnë të dhënat, për mënyrën sesi do të përpunohen të dhënat dhe të drejtat e subjektit për të pasur akses apo për ti korrigjuar ato, në zbatim të nenit 18 pika 1) të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar.

Përdorimi i teknologjive të reja përmes përdorimit të internetit lejon mbledhjen e lehtë, të shpejtë dhe përpunimin e një numri të madh të të dhënave personale. Përdorimi i këtyre sistemeve apo teknologjive sjell përfitime për kontrolluesit dhe për subjektet e të dhënave personale, ato gjithashtu paraqesin një sfidë për mbrojtjen e vazhdueshme të të drejtave themelore të njeriut. Këto të drejta, në veçanti të drejtat për mbrojtjen e të dhënave personale, nuk duhet të minohen ose dobësohen thjesht sepse këto sisteme e kanë bërë më të lehtë ose më fitimprurës përpunimin e të dhënave.

Mbledhja, përpunimi dhe ruajtja e të dhënave personale duhet të kryhen sipas parimit të respektimit dhe garantimit të drejtave dhe lirive themelore të njeriut dhe në veçanti të drejtës së ruajtjes së jetës private. Mbrojtja e të dhënave personale është një e drejtë themelore dhe është e sanksionuar edhe në Traktatin e Lisbonës. Karta e të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian parashikon se: *“Gjithkush ka të drejtën e mbrojtjes së të dhënave personale në lidhje me veten e tij apo të saj. Të dhëna të tilla duhet të jenë të përpunuara në mënyrë të drejtë për qëllimet e specifikuar dhe në bazë të pëlqimit të personit të interesuar, ose në bazë legjitime të përcaktuara me ligj. Gjithkush ka të drejtën e aksesit ndaj të dhënave të cilat janë mbledhur në lidhje me të, dhe të drejtën për të korrigjuar të dhënat”*.

Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale konstaton se kontrolluesi “*Interalbanian*” *Vienna Insurance Group*, në faqen e tij në internet www.interalbanian.com nuk ka të publikuar rubrikën “*politikat e privatësisë*”, me qëllim informimin e personave që vizitojnë këtë faqe mbi mënyrat e mbledhjes, përpunimit, ruajtjes, si dhe masat e marra për sigurinë e të dhënave personale. Në këtë rubrikë duhet të publikohen të drejtat e subjekteve të të dhënave dhe detyrimet e kontrolluesit në kuadër të mbrojtjes së privatësisë. “*Politikat e privatësisë*” synojnë sensibilizimin e publikut mbi rëndësinë e mbrojtjes së privatësisë dhe të drejtat që gëzojnë në këtë fushë.

Mungesa e rubrikës “*politikat e privatësisë*” në faqen tuaj në internet www.shkp.gov.al përbën shkelje të neneve 18 dhe 27 të ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008, “*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*”, i ndryshuar.

Autoriteti i Komisionerit vlerëson parimin e transparencës së çështjeve të ndryshme sidomos edhe në faqen tuaj të internetit si kontrollues, por thekson edhe rëndësinë e transparencës në përpunimin e informacionit të subjekteve të të dhënave në mënyrë që këta të fundit të kenë dijeni mbi: personat që njihen me të dhënat e tyre, qëllimin dhe mënyrën e përdorimit të të dhënave, kujt do t’i përhapen të dhënat, mbrojtjen e privatësisë, etj. Për këtë arsye çdo individ/subjekt i të dhënave personale ka të drejtën e mbrojtjes së duhur të të dhënave të tij personale. Përpunimi i të dhënave personale duhet të lejohet për aq sa është i nevojshëm, i drejtë, i ligjshëm dhe proporcional.

Për sa më sipër:

Në mbështetje të neneve 29, 30 dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, si dhe nenet 107-109 të K. Pr. Administrative ;

REKOMANDOJ

1. Kontrolluesi në faqen online në rubrikat “Apliko online”, “Kontakto për pyetje” dhe “Njoftimi i dëmit”, në formularët përkatës të vënë në dispozicion nga kontrolluesi në faqen e tij online www.interalbanian.com. ku plotësohen të dhëna personale të subjekteve (aplikant/kontaktues dhe të dëmtuar), duhet të informojë në mënyrë të qartë e të shprehur për qëllimin e përpunimit, mbledhjes së të dhënave personale të subjekteve në zbatim të nenit 18 pika 1) të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar.
2. Në zbatim të neneve 18, 27 të Ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008 “ Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar, në faqen tuaj në internet duhet të publikohen “politikat e privatësisë” (paketë rregullash) me qëllim informimin e personave që vizitojnë faqen mbi mënyrat e përpunimit të të dhënave personale, masat e sigurisë dhe ruajtjes së konfidencialitetit, të drejtat e subjekteve të të dhënave dhe detyrimet e kontrolluesit në kuadër të mbrojtjes së privatësisë. Politikat e privatësisë synojnë sensibilizimin e publikut mbi rëndësinë e mbrojtjes së privatësisë dhe të drejtat që gëzojnë në këtë fushë.
3. Kryerja e këtyre detyrimeve të rëndësishme të kryhen brenda një afati kohor prej 30 (tridhjetë) ditësh, nga momenti i marrjes dijeni të këtij rekomandimi.
4. Me plotësimin e këtyre detyrimeve të njoftohet me shkrim pranë Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale;
5. Në rast mospërbushje të këtij Rekomandimi, Komisioneri vepron sipas nenit 30, pika 2, të ligjit “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, sipas të cilit “Komisioneri në rast shkeljesh serioze të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të moszbatimit të rekomandimeve të tij, vepron sipas nenit 39 të këtij ligji dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave”.

